



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Raporti i anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve

Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve u mbajt me datën 22 tetor 2014.

Qëllimi i Anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve nga Agjencia e Statistikave të Kosovës kishte për qëllim që të marrim informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikave në të ardhmen.

Kjo anketë është realizuar gjatë konferencës së mbajtur me shfrytëzuesit e të dhënave statistikore, i të cilës u janë përgjigjur 11 shfrytëzues të këtyre të dhënave. Pyetësi ka përmbajtur 8 pyetje.

Nga raporti i anketës del se më pak se gjysma e të intervistuarve me 45,5 % i përdorin të dhënat statistikore disa herë në muaj, ndërsa me 27,3% përdorin të dhënat disa herë në javë dhe disa herë në vit.

Me tepër se gjysma e të intervistuarve me 54,5% i përdorin të dhënat statistikore nga 5 vite e më shumë, me shumë se një e katërta 27,3% i kanë përdorur të dhënat statistikore nga 1 deri në 3 vite. Ndërsa me 18,2% i përdorin nga 3 deri në 5 vite., Nga ku shihet se nuk kemi pasur shfrytëzues që kanë më pak se një vit duke i përdorur të dhënat statistikore.

Shumica më e madhe e të intervistuarve i përdorin të dhënat statistikore për qëllime hulumtimi, për politikë bërje, për qëllime studimi, etj.

Nga të dhënat e gjithmbarshme më së shumti përdoren të dhënat nga statistikat e popullsisë, të tregut të punës, mirëqenies social, standardit jetësor dhe edukimit, pastaj të dhënat nga çmimet, llogaritë kombëtare dhe tregtinë e jashtme e kështu me radhë.

Shumica e shfrytëzuesve informatat i marrin përmes publikimeve, pastaj përmes mediave si dhe komunikatës për shtyp.

Gati dy të tretat e shfrytëzuesve 63,6 % e vizitojnë ueb faqen e ASK-së disa herë në muaj.

Lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të ASK-së, nivelin mesatar të pajtueshmërisë e arrijmë me këtë përqindje: në përgjithësi të kënaqur me 36,4%, i plotësojnë nevojat e shfrytëzuesve me 27,3% , të dhënat janë të cilësisë së lartë me 54,5%, statistikat në përgjithësi janë të krahasueshme me 36,4%, të dhënat publikohen në kohë me 45,5% si dhe 54,5% janë të cilësisë së lartë.

Nivel më të lartë të pajtueshmërisë lidhur me statistikat në përgjithësi arrijmë me këtë përqindje: në përgjithësi të kënaqur me të dhënat statistikore, me cilësinë e statistikave, me krahasueshmërinë dhe me besueshmërinë me një përqindje prej 27,3%. Ndërsa, sa i plotësojnë kërkesat e tyre, sa ato publikohen në kohë dhe sa baza e këtyre të dhënave është plotësisht e mbrojtur ka rezultuar me 45,5%.

Përqindje më të vogël të përgjigjeve kemi te niveli i pajtueshmërisë plotësisht.

Vlen të potencohet se një përqindje e konsiderueshme e shfrytëzuesve të të dhënave nuk e dinë që baza e të dhënave është plotësisht e mbrojtur (konfidenciale).

Duke marrë për bazë opinionin e gjithmbarshëm të të anketuarve rezulton si në vijim:

- Të dhëna të publikohen në formatin excel dhe në seri më të gjata kohore;
- Të dhënat të publikohen me më shumë disagregime të variablave;
- Analizat statistikore të jenë më të hollësishme;
- Përshkrimi dhe dokumentimi të jenë më në detaje, po ashtu edhe i raporteve që jepen në mënyrë tabelare;
- Azhurnimi i të dhënave të publikuara sidomos i tabelave në Excel dhe i vizualizimit të të dhënave nëpër komuna me harta të reja etj.
- Poashtu një ndër kërkesat e shfrytëzuesve ka qenë edhe përmirësimi i kualiteti të të dhënave, publikimi në kohe, krahasueshmëria, etj.